

# **RREGULLORE**

## **MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË KSSH-së**

### **Kreu 1**

#### **DISPOZITA KRYESORE**

##### **Neni 1**

###### **Statusi i Asamblese se Pergjithshme**

1. Asambleja e Pergjithshme (këtu e më poshte AP) e Konfederates se Sindikatave te Shqiperise (KSSH) eshte forumi me i larte vendimmarres ne perjudhen midis Kongreseve te KSSH dhe institucioni kryesor pergjegjes per organizimin dhe drejtimin e punes se Konfederates se Sindikatave te Shqiperise(KSSH) ne zbatim te vendimeve dhe orjentimeve te kongresit, statutit, kesaj rregulloreje dhe cdo aktiviteti tjetër te saj ne shkalle kombetare.
2. Vendimet e saj jane detyrimisht te zbatueshme nga te gjitha strukturat organizative dhe ndihmese te KSSH, nga qendra deri ne baze (organizata sindikale, keshilla sindikale, keshilla bashki, komunash, rrethesh, qarqesh, Sindikatash qendrore profesioni, federatash, dhe cdo strukture tjetër) si dhe prej te gjithe anetareve te saj.

##### **Neni 2**

###### **Numri dhe perberja e Asamblese se Pergjithshme**

1. Struktura e anetareve te Asamblese se Pergjithshme, si rregull, mund te vendoset nga kongresi i KSSH. AP e KSSH ne funksion te mbarvajtjes se aktivitetit te AP, mund te vendos per zevendesimin e anetareve te AP sipas parashikimeve qe behen ne nenin 6. Pika 9 dhe 10 te kesaj rregulloreje.
2. Asambleja e Pergjithshme(AP) e KSSH nga ana strukturore, si rregull perbehet:
  - a. Presidenti i KSSH
  - b. 3(tre) zv.Presidente te KSSH.
  - c. Sekretari Organizativ i KSSH.
  - d. Presidentet e Federatave te Profesioneve anetare te KSSH.
  - e. Drejtuesit e Sindikatave Qendrore te degeve te profesionit(nese ka)
  - f. Koordinatorët e Keshillave Sindikale te Qarqeve.
  - g. Sekretaret Rajonal te Rretheve.

- h. 35 anetare nga rradhet e Sindikatave, dhe Federatave sipas numrit te anetaresise me kuota, te depozituara prane KSSH-së dhe te miratuara nga kjo e fundit.
- i. Kordinatorin e rrjetit te gruas.
- j. Kordinatorin e rrjetit te Rinise.
- k. Drejtorin e Qendres se Trajnimit dhe Studimeve Sindikale.
- l. Sekretarin e Komisionit te gjykimit Disiplinor.
- m. Sekretarin e Komisionit te finances dhe auditit.
- n. Sekretarin e komisionit te statutit.
- o. Pergjegjsin e Departamentit te Burimeve njerezore te KSSH.
- p. Anetaret e zgjedhur nga vet AP sipas parashikimeve dhe rasteve te parashikuara ne kete rregullore.

Neqoftese nje anetar i Asamblese ka funksione te dubluara, atehere ne Asamble merr pjese nje person tjeter i mandatuar nga struktura perkatese qe perfaqesohet.

Cdo ndryshim i ketyre personave miratohet paraprakisht nga Asambleja e Pergjithshme e KSSH.

### **Neni 3**

#### **Mbledhja konstituuese e Asamblese se Pergjithshme**

1. AP e KSSH, ne mbledhjen e saj te pare, konstituon dhe miraton nominalisht(emer per emer), Asamblene e Pergjithshme te KSSH. brenda 45 diteve nga dita e Kongresit, mbeshtetur ne vendimet e Kongresit , ne statutin e KSSH dhe ne kete rregullore.
2. AP zgjedh 3 zv.Presidente dhe Sekretarin Organizativ.
3. Asambleja e Pergjithshme(AP) e KSSH:
  - a. Miraton ndryshimet permirsimet ne rregulloret per praktiken e organizimit, funksionimit, dhe dokumentimit te veprimtarise se Konfederates, ne baze te rregullores perkatese, e cila miratohet nga AP e KSSH.
  - b. Zgjedh komisionet dhe strukturat perkatese ne perputhje me statutin e KSSH.
  - c. Miraton sekretarin organizativ te KSSH ne perputhje me statutin.
  - d. Ben zevendesimin e Anetareve te AP te cilet ne perputhje me kete rregullore jane vet larguar ose jane perjashtuar.
  - e. Ne cdo kohe, pezullon ose perjashton deri ne nje vendim te kundert te AP ose Kongresit(ne menyre te shprehur ose te heshtur), Federatat apo Sindikatat qe nuk plotesojne detyrimet ndaj KSSH-se, ose shkelin rregullat e funksionimit te parashikuara ne aktet qe rregullojne veprimtarine e KSSH-së, perfshi edhe kete rregullore. Ne rastin e pezullimit, perfaqesuesit qe mund te kishte kjo Federate ose Sindikate ne Organet vendimarrrese te KSSH-se, nuk llogariten ne Kuorumin per vendimarrje, apo per cfardolloj efekti tjeter ne marrdhenjet me KSSH-në.

Pezullimi sjell te gjitha efektet e nje perjashtimi te perkohshem, deri ne nje vendim te dyte te AP ose deri ne vendimarrje te kundert te kongresit.

- f. Miraton, perpara se te hyjne ne fuqi, rregulloret e Asambleve te KSSH ne nivel territorial.
- g. Miraton numrin e delegateve per ne kongresin e KSSH-se, verifikon dhe miraton paraprakisht dhe nominalisht cdo delegat, duke pare perputhshmerine e mandatit te tij me statutin e KSSH-se. Ne rast refuzimi te miratimit te delegatit, i kerkon strukture qe perfaqesohet te bej zevendesimet perkatese, ne te kundert, pervec sanksioneve ndaj strukture qe nuk ka bere apo ka rrefuzuar propozimin, urdheron zevendesimin e delegatit/ve ose perjashtimin apo pezullimin e strukture qe nuk ka bere zevendesimin.

Nuk mund te zevendesohen anetaret e Presidjunit, Presidentet e Federatave dhe Presidentet e Sindikatave, pervec kur struktura qe ata drejtojne eshte perjashtuar ose pezulluar.

- h. Urdheron riorganizime ose rithemelime te strukturave te KSSH-se, te reja apo ekzistuese, perfshi Sindikatat dhe Federatat, ne perputhje me dinamikat e tregut te punes ne Shqiperi.
- i. Verifikon ne shkalle te fundit numrin e anetareve te deklaruar nga strukturat e KSSH, ne rrethe, qarqe, sindikata, federate sindikale dhe cdo strukture tjeter e KSSH qe merren me anetaresine ne terren. Numri i anetareve te konstatuar nga AP e KSSH-se eshte perfundimtar dhe i pa kundershueshem.

Numeri i anetaresise i konstatuar nga AP llogaritet per cdo marrdhenie brenda KSSH-se, apo ne raportet e KSSH-se me organizata apo institucione kombetare dhe nderkombetare.

- j. Kryen cdo detyre tjeter te percaktuar ne statutin, ne Kongresin e KSSH dhe kete Rregullore.

## **KREU 2**

### **FUNKSIONIMI I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

#### **Neni 4**

##### **Thirrja e Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

1. Asambleja e Pergjithshme e KSSH thirret ne mbledhjen e saj, jo me pak se 2 here ne vit.
2. Mbledhja e KSSH thirret me kerkese te Presidentit te KSSH ose te jo me pak se 1/2 te anetareve te saj.

3. Presidenca percakton rendin e dites jo me vone se 10 dite para mbledhjes se AP. Data, ora dhe vendi i mbledhjes u njoftohet anetareve te asamblese jo me vone se tre dite para mbledhjes, si dhe u jepen materialet e mbledhjes.
4. Presidenti i KSSH per problem te nje rendesie te vecante therret mbledhjen e AP te KSSH brenda 3 diteve nga data e njoftimit.
5. Ne rastet kur mbledhja thirret nga  $\frac{1}{2}$  e anetareve te AP, keta te fundit, i dorezojne kerkesen me shkrim Presidentit te KSSH, i cili ja ben ate te njohur Presidences Ekzekutive te KSSH. Kerkesa duhet te kete te argumentuar ceshtjen/ceshtjet per te cilat kerkohet zhvillimi i mbledhjes si dhe emrat dhe nenshkrimet e kerkuesve te noterizuara. Mbledhja e AP zhvillohet jo me vone se 30 dite nga data e miratimit (te shprehur ne nje vendim) te kesaj kerkese, nga Presidenca Ekzekutive e KSSH.  
Ky vendim si dhe rendi i punimeve te mbledhjes se AP, kur thirret sipas pikes 5 te ketij neni, duhet te miratohet me jo me pak se  $\frac{2}{3}$  e anetareve te Presidences Ekzekutive te KSSH.
6. Procedura e thirrjes se mbledhjeve te AP parashikuar ne kete nen, zbatohet detyrimisht (per efekt vlefshmerie), si per mbledhjet e zakonshme ashtu edhe per ato te jashtzakonshme.
7. Ne mbledhjen e AP mund te ftohen te marrin pjese edhe qytetare, anetare e simpatizante te KSSH, apo specialist te problemeve qe diskutohen.

## **Neni 5**

### **Masat per gatitore per zhvillimin e mbledhjes**

1. Masat per pergatitjen e mbledhjes se AP, si njoftimi i anetareve dhe te ftuareve , pergatitja dhe shumfishimi i materialeve nga grupet e punes te ngarkuara nga aparati i KSSH, etj koordinohen nga Sekretari Organizativ i KSSH ne bashkpunim me Presidentin e KSSH.
2. Te gjitha projektvendimet, per te cilat duhet te jap voten e vet AP, duhet qe me pare te kene marre mendimin e Presidences Ekzekutive te KSSH ose  $\frac{1}{2}$  e firmave te anetareve te AP.
3. Ne rastet kur asambleja e Pergjithshme e KSSH mblidhet per problem te nje rendesie te vecante, anetaret e saj marrin njohuri per rendin e dites kur vijne ne mbledhje. Per procedim te metejsheem ne kete rast vendos Asambleja e Pergjithshme.

## **Neni 6**

### **Zhvillimi i mbledhjes**

1. Mbledhja e AP hapet kur jane present jo me pak se gjysma e anetareve te AP.
2. Presidenti i KSSH, tre zv. Presidentet dhe Sekretari Organizativ perbejne presidjumin e punes per drejtimin e AP-se.
3. Punimet e AP i drejton Presidenti i KSSH, dhe ne mungese te tij, njeri nga tre zv. Presidentet, i autorizuar me shkrim nga Presidenti i KSSH.  
Ne rastin e fundit rendi i dites miratohet paraprakisht nga Presidenti i KSSH.
4. Ne fillim miratohet rendi i dites i mbledhjes se AP dhe nese mbledhja ose séanca te vecanta te saj zhvillohen me dyer te hapura apo te mbyllura sipas ceshtjeve qe do te diskutohen ne to.
5. Propozimi per zhvillimin me dyer te hapura ose te mbyllura te mbledhjes se AP behet nga Presidenti i KSSH, apo te ½ te anetareve te AP, kerkese e cila duhet te jete e motivuar. Miratimi behet me votim te hapur dhe me shumice te thjeshte te votave te anetareve pjesmarres ne mbledhje.
6. Kur AP vendos qe mbledhja ose séanca te vecanta te saj te zhvillohen me dyer te hapura, marrin pjese te ftuarit dhe media.
7. Ne perputhje me karakterin e problemeve qe do te diskutohen, drejtuesi i mbledhjes kerkon mendim per kohen ne dispozicion te cdo diskutanti. Kohzgjatja e cdo diskutimi vendoset nga forumi me votim te hapur.
8. Te drejten e dhenjes se fjales per diskutim, replike, etj. e ka drejtuesi i mbledhjes.
9. Kur nje anetar i AP mungon dy here pa arsye ne mbledhjet e AP, konsiderohet i vet larguar nga kjo strukture, pa qene i nevojshem ndonje vendim perjashtimi nga AP.  
Ne kete rast plotesimi i vendit vakant behet me propozim te strukturave perkatese qe perfaqesohen ne kete pozicion. Ne rast se kjo strukture nuk e ploteson vendin vakant brenda nje kohe te arsyeshme qe vendoset nga AP, atehere vendi vakant plotesohet nga vet AP. Per kete rast AP mund te marre edhe mendimin e strukturave te KSSH qe mbulojne sektorin perkates. Ne rastin e fundit Presidenti i KSSH mund te propozoje edhe masa ndeshkuese ndaj strukture qe nuk ka propozuar zevendesimin.
10. Ne cdo rast, per shkaqe te arsyeshme, AP mund te vendos perjashtimin e cdo anetari te AP (pervec anetareve te Presidjunit, Presidentet e Federatave dhe Presidentet e Sindikatave).  
Per zevendesimin e tij/tyre (plotesimin e vendit vakant) veprohet si ne piken 9 te ketij neni.
11. Ne funksion te zhvillimit te mbledhjes te AP te KSSH funksionon nje sekretari, e perbere nga punonjes te aparatit te KSSH, e cila kryen detyrat ne perputhje me statutin e KSSH dhe kete rregullore.

## **Neni 7**

### **Marrja dhe zbatimi i vendimeve**

1. AP merr vendime kur ne mbledhje marrin pjese ne shume se gjysma e anetareve te saj. Ne rast se ky numer nuk plotesohet, atehere marrja e vendimit shtyhet per aq kohe sa te sigurohet numeri i nevojshem.
2. Ne te gjitha rastet drejtuesi i mbledhjes, nepermjet sekretarise kerkon verifikimin e sakte te pjesmarresve. Verifikimi mund te behet edhe me ane te apelit.
3. Vendimi quhet i vlefshem kur per te kane votuar shumica e anetareve pjesmarres ne mbledhjen e AP. Pervec perjashtimeve te parashikuara ne statutin e KSSH.
4. Ne vendim mund te percaktohet qarte objekti dhe detyrat funksionale-organizative, strukturat sindikale qe duhet ta zbatojne dhe afatet e zbatimit.
5. Drejtuesit e AP dhe Presidenca Ekzekutive ndjekin kontrollin e zbatimit te vendimeve te AP te KSSH.

## **Neni 8**

### **Votimi**

1. Pas perfundimit te diskutimit te problemit, te fjales permbledhese te referuesit dhe te drejtuesit te seances, ose Presidentit te KSSH, ceshtjet shtrohen per votim.
2. Ne votim marrin pjese vetem anetaret e AP.
3. Votimi eshte vetjak. E drejta e votes nuk mund te delegohet.
4. Rradha e votimit te vendimeve i permbahet radhes se diskutimit te problemeve, duke proceduar me pare me propozimet per ndryshimet dhe shitesat(nese ka te tilla) pastaj votohet projekt vendimi i paraqitur nga raportuesi i problemit dhe, ne fund per propozimet apo ndryshimet anesore.
5. Votimi ne AP sipas karakterit te problemeve, mund te behet i hapur ose i fshehte.
6. Votimi i hapur behet per te vendosur per ceshtje te tilla sic jane ato per miratim te rendit te dites, per deklarata, rezoluta, komisione e grupe pune, etj.
7. Me kerkesen e motivuar te 1/3 te anetareve te AP ose te Presidentit te KSSH dhe me miratim te AP. Votimi i hapur mund te behet nominal.
8. Votimi i fshehte behet me Propozim te Presidentit te KSSH, kur propozohen kandidatura alternative, ose jo. Si dhe kur per nje anetar te AP shqyrtohet nje problem apo mase me karakter vetjak.
9. Per problem te vecanta me karakter tekniko administrative, pasi AP ka votuar dhe vendosur ne parim, mund ti delegoj Presidencas Ekzekutive percaktimin e modaliteteve konkrete. Per kete AP informohet ne mbledhjen me te afert.

## **Neni 9**

### **Dispozita te fundit**

1. Procesverbali i mbledhjes se AP te KSSH i zbardhur dhe vendimet e saj firmosen, per efekt vlefshmerie, nga Presidenti i KSSH. Kopja e vendimit depozitohet ne arkivin e KSSH.

2. Vendimet e AP te KSSH mund te kundershohen nga pala e interesuar brenda 10 diteve nga marrja e tyre. Ne te kundert jane te pakundershtueshem per palen e interesuar.
3. Cdo anetar i AP i cili me arsye ka munguar ne mbledhjet e AP ka te drejte te njihet me materialet e mbledhjes. Me kerkese te tij i vihen ne dispozicion materialet e cdo mbledhjeje.
4. Ne raste te tjera studimi i materialeve mund te behet vetem me autorizim paraprak te Presidentit te KSSH.
5. Ndryshimet ne kete rregullore mund te behen vetem nga AP me propozim te Presidentit te KSSH ose me kerkesen me shkrim te  $\frac{1}{2}$  te anetareve te AP. Ne rastin e fundit (me propozim te  $\frac{1}{2}$  te anetareve te AP) kerkesa e tyre procedon ne menyre analoge me proceduren qe parashikon neni 4, pika 5 e kesaj rregulloreje.
6. Parashikimet e bera ne kete rregullore, ne raport me aktet e tjera qe rregullojne veprimtarine e AP te KSSH, kane fuqine e parashikimeve te nje akti specific, te posacem. Nderkohe qe aktet e tjera jane akte te pergjithshme dhe parashikojne norma te pergjithshme ne parim, per funksionimin e AP te KSSH-së.
7. Kjo rregullore sherben si rregullore tip per funksionimin e Asambleve te KSSH ne nivel territorial.
8. Keto rregulla, te parashikuara ne kete rregullore, jane materializim i praktikes shume vjecare qe KSSH ka ndjekur ne funksionimin e Organit me te Larte Vendimarrës te saj, ne perjudhat midis kongreseve, gjate viteve te kaluara.
9. Cdo marrdhenje apo konflikt qe hyn ne rregullimet qe ben kjo rregullore, dhe qe ka lindur, qofte edhe perpara miratimit te kesaj Rregulloreje, dhe qe vazhdon edhe sot, do te zgjidhet sipas parashikimeve qe ben kjo rregullore.
10. Kjo rregullore hyn ne fuqi dhe eshte e detyrueshme per zbatim, daten e miratimit nga AP e KSSH-së. Pervec rasteve te pikes 8 te ketij neni, per te cilat ka fuqi edhe perpara kesaj date.

**Miraturar me vendimin nr. 5 date 17/07/2010 te Asamblese se Pergjithshme te KSSH.**

**Presidenti i KSSH  
Kol NIKOLLAJ**